



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Shëndetësisë dhe
Mbrojtjes Sociale

Nr. 1864, datë 04.04.2022

Ministria e Financave dhe
Ekonomisë

Nr. 6087/144, datë 04.04.2022

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 211, datë 04.04.2022

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PUNËSIM TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”,

URDHËROJMË

1. Miratimin e planit të masave për punësimin e personave me aftësi të kufizuar në moshë aktive pune, sipas planit të masave që i bashkëlidhet këtij urdhëri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, strukturat e përcaktuara për realizimin e aktiviteteve, sipas planit të masave.
3. Ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri drejtoria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe drejtoria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËS MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Denada SEFERI



ZËVENDËS MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Olta MANJANI



PLANI I MASAVE PËR PUNËSIMIN E PAK

	I. OBJEKTIVI	AFATI	INDIKATORI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS
	Informimi, aftësimi, nxitja e punësimit dhe integrimi në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara në moshë pune, të gatshëm për punë dhe të aftë për punësim			
1.	Sigurimi i informacioneve të aksesueshme për shërbimet dhe programet e aftësimin profesional dhe punësimit për personat me aftësi të kufizuara (PAK) që kërkojnë punë përmes shërbimeve të ofruara nga zyrat e punësimit dhe aftësimin profesional si edhe përmes Portalit Kombëtar të Punësimit të AKPA.	Maj-2022	Informacion i aksesueshëm mbi programet e nxitjes së punësimit	MSHMS MFE AKPA
2.	Nxitja e PAK drejt regjistrimit si punëkërkuar të papunë në zyrat e punës.	Cdo muaj 2022	Referimi i rasteve specifike nga Komisionet Multidisiplinare të reformës PAK dhe nga SHSSH	SHSSH AKPA
3.	Sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi i Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit (SMI) të PAK dhe SMI të Punësimit.	Qershor 2022	Informacioni i shkëmbyer në kohë reale	MSHMS MFE AKPA SHSSH
4.	Hartimi i profileve individuale për cdo PAK	Cdo muaj gjatë vitit 2022	Përgatitja e profileve për 3000 PAK në vit	
5.	Shërbimi Social Shtetëror referon listën me profilet e Përfituesve të PAK pranë AKPA. Pilotimi në qarqet Tiranë dhe Elbasan.	Maj 2022	Listat e përmuajshme	SHSSH
6.	PAK të referuar nga SHSSH që janë në moshë pune intervistohen nga punonjësit e zyrave të punës nëse janë të gatshëm për punë dhe të aftë për punësim.	2022	Vlerësimi nga zyrat e punës i 3000 PAK në vit të referuar nga SHSSH	AKPA

7.	Ofrimi i këshillimit nga të gjitha zyrat e punës për punësim në lidhje me përshtatshmërinë e punës, opsionet e mbështetjes, rrugët e karrierës dhe trajnimin.	Prill e në vijim 2022	1500 PAK në vit do të përfitojnë shërbim për punësim në lidhje me përshtatshmërinë e punës, opsionet e mbështetjes, rrugët e karrierës dhe trajnimin	AKPA
8.	Ofrimi i programeve të nxitjes së punësimit, ndërmjetësimit për punësim, formimit, praktikave profesionale, vetëpunësimit për PAK pas përgatitjes së profilit, dhe regjistrimit të tyre si punëkërkues të papunë gjatë intervistës.	Gjatë vitit 2022	100 PAK në vit do jenë pjesë e programeve të nxitjes së punësimit, ndërmjetësimit për punësim, formimit, praktikave profesionale, vetëpunësimit	AKPA
9.	Adresimi i PAK drejt programeve të subvencionuara nga Fondi Social i Punësimit.	Gjatë vitit 2022	100 PAK do përfitojnë programet e subvencionuara pas krijimit të Fondit Social të Punësimit	SHSSH AKPA
10.	Ofrimi i kurseve të aftësisimit profesional pa pagesë për PAK që janë punëkërkues të papunë të rregjistruar në Zyrat e Punësimit dhe zgjerimi i tipologjisë së tyre.	Gjatë vitit 2022	300 PAK në vit do përfitojnë kurse të aftësisimit profesional pa pagesë	AKPA
11.	Ngritja e kapaciteteve të stafit të aftësisimit profesional dhe punësimit në nivel rajonal e vendor për të asistuar me shërbime personat me aftësi të kufizuara.	Gjatë vitit 2022	Trajnimi i stafit të 12 Drejtorive Rajonale të Punësimit dhe Zyrave Vendore të Punësimit	MSHMS MFE
12.	12 grupet rajonale të punës të ngritur për punësimin e kategorive në nevojë (DRSHSSH, DRPAP, NJVV) do të funksionojnë si një komision trepalësh	Cdo muaj të vitit 2022	40 raste në muaj për çdo grup rajonal	MSHMS MFE

	edhe për vlerësimin e aplikimit, profilit social ekonomik dhe përcaktimin e protokollit për punësimin e PAK.			NJVV
13.	Hartimi i kurrikulave dhe ofrimi i kurseve për kualifikimin e ndihmësve personalë të PAK.	Gjatë vitit 2022	Kurrikula e hartuar Trajnimi i NJVV-ve	MSHMS DONATOREË
14.	Promovimi i rasteve pozitive të punësimit në subjektet private dhe publike, si dhe rasteve që kanë përfunduar kurset e aftësimi profesional apo programeve të praktikave profesionale.	2022	50 të punësuar deri në Qershor 2022	MFE AKPA
15.	Subvencionim pagash për punëdhënësit që janë të gatshëm të punësojnë një PAK dhe t'i ofrojë përvojë aftësimi profesional, duke përfshirë stazhin.	2022-2023	Subvencionimi i pagave të punëdhënësve	AKPA